

BANKA E SHQIPËRISË

DEKLARATË PËR SHTYP

ZHVILLIMET NË SEKTORIN E
JASHTËM TË EKONOMISË PËR
NËNTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2007

NËNTOR 2007

DEKLARATË PËR SHTYP

ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË PËR NËNTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2007

NËNTOR 2007

Sektori i jashtëm i ekonomisë, për nëntëmuja e parë të vitit 2007, paraqitet me një bilanc të thelluar negativ në llogarinë korente, shkaktuar nga një deficit i lartë tregtar.

Flukset hyrëse në kapitale kanë qenë të mjaftueshme për kompensimin e deficitit korent, duke mundësuar një bilanc të përgjithshëm pozitiv në nivelin 172.7 milionë euro.

Zhvillimet kryesore në sektorin e jashtëm të ekonomisë shqiptare mund t'i përgjithësojmë në:

- Aktivitet intensiv në sektorin e jashtëm, i shprehur në rritje të të ardhurave dhe të shpenzimeve korente.
- Rritje e konsiderueshme në eksporte dhe në importe mallrash.
- Thellim i deficitit korent dhe atij tregtar.
- Rritje e flukseve hyrëse të kapitalit të huaj në formën e investimeve të huaja direkte.
- Rritje në detyrimet financiare ndaj jorezidentëve, të krijuara në formën e rritjes së depozitave të jorezidentëve në sistemin bankar.
- Rritje në stokun e rezervave valutore të autoritetit monetar.

I. LLOGARIA KORENTE

Transaksionet korente, të zhvilluara gjatë nëntëmuja të parë të vitit 2007, vlerësohen në rreth 6.2 miliardë euro ose 21 për qind më të larta se në vitin paraardhës. Shkëmbimet tregtare në mallra dhe shërbime kryesojnë vëllimin e transaksioneve korente të Shqipërisë me botën. Mëse 94 për qind e shpenzimeve korente, gjatë kësaj periudhe, kanë shkuar për blerje mallrash dhe shërbimesh ndërkohë që, rreth 32 për qind e të ardhurave korente kanë hyrë në formën e transfertave. Eksportet në mallra dhe shërbime siguruan përkatësisht 21 për qind dhe 39 për qind të të ardhurave korente.

Deficiti i lartë tregtar që karakterizon zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë shqiptare, ka neutralizuar efektet pozitive të zvogëlimit të ndjeshëm të pozicionit deficit në llogarinë e shërbimeve si dhe rritjes së suficitit të të ardhurave faktoriale neto, duke mbetur shkaktari kryesor në thellimin e deficitit korent edhe për këtë periudhë.

Deficiti korent, për këtë nëntëmujor vlerësohet në rreth 579 milionë euro, me një rritje nominale prej rreth 188 milionë eurosh (ose 48 për qind), kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2006.

I. 1. TREGTIA E JASHTME

Tregtia e mallrave, përbën komponentin kryesor të shkëmbimeve tona korente me pjesën tjetër të botës. Gjatë këtij nëntëmujori ato përfaqësuan 43 për qind të tyre, duke regjistruar një vëllim të përgjithshëm tregtar prej 2.7 miliardë eurosh.

Shpenzimet për import mallrash shënuan afërsisht vlerën 2.1 miliardë euro ose 423 milionë euro më shumë, krahasuar me vitin 2006. Të ardhurat nga eksporti i mallrave vlerësohen në rreth 589 milionë euro, me një rritje nominale prej rreth 125 milionë eurosh.

Orientimi i theksuar i ekonomisë shqiptare drejt importit vazhdon të karakterizojë edhe këtë periudhë, duke rezultuar në thellim të mëtejshëm të deficitit tregtar. Gjatë kësaj periudhe Shqipëria regjistroi deficitin tregtar më të lartë në vite, prej 1.5 miliardë eurosh ose 25 për qind më i lartë krahasuar, me një vit më parë.

Deficiti tregtar ka përbërë një tipar të përhershëm të zhvillimeve të tregtisë së jashtme, duke diktuar nivelet e larta të deficitit të llogarisë korente. Kërkesa e lartë për importe, për nevoja të rritjes ekonomike dhe njëkohësisht për të plotësuar nevojat e popullsisë në mallra konsumi, ka evidentuar dukshëm zgjerimin e bazës së importeve në vite. Kjo dinamikë, megjithatë, nuk është pasuar me fuqizimin në bazë të gjerë të eksporteve, duke bërë që hendeku tregtar të thellohet dhe të përbëjë faktorin kryesor për deficite të larta korente.

Rritja e importeve, vërejtur përgjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2007, është bashkërrjedhojë e disa faktorëve të jashtëm – rritja e pazakontë e çmimeve të naftës si dhe rritja e çmimeve të disa mallrave në tregjet ndërkombëtare – dhe e faktorëve të brendshëm – situata e përkeqësuar energjitike në vend, e cila ka çuar në importe të larta në energji elektrike. Këtë vit ato u rritën me rreth 25 për qind, nga 17 për qind që ishte rritja për të njëjtën periudhë në vitin e kaluar.

Megjithatë, deficiti tregtar mund të kishte qenë akoma më i përkeqësuar pa progresin e vërejtur këtë vit në eksporte. Eksportet u rritën me rreth 27 për qind nga 16 për qind që ishte rritja e vërejtur gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2006.

Megjithë situatën e përkeqësuar në furnizimin me energji elektrike në vend, edhe ky vit pasoi me ritme të larta në eksporte, me kontribut kryesor nga industritë kyçe të eksporteve shqiptare (përsëri pothuajse gjysma e eksporteve (48 për qind) mbetet e përqendruar ndjeshëm në tekstile dhe veshjet e këmbëve).

Ndërkohë, çmimet e larta në tregjet ndërkombëtare kanë stimuluar ndjeshëm eksportin e brendshëm (gjatë vitit 2007 janë rritur ndjeshëm eksportet në naftë të parafinuar si dhe në mineral kromi), duke kontribuar në ritme të larta të të ardhurave nga eksporti i mallrave edhe për vitin 2007.

I. 2. ZHVILLIMET NË ZËRAT E TJERË TË LLOGARISË KORENTE.

Tregtia e shërbimeve, gjatë këtij nëntëmujori është prirur drejt zgjerimit të shkëmbimeve tregtare me botën dhe ngushtimit të pozicionit të deficitit, duke mbetur nën të njëjtat tendenca të shfaqura gjatë viteve të fundit.

Shkëmbimet tregtare në shërbime vlerësohen në rreth 2.2 miliardë euro, me një rritje vjetore prej 18 për qind, kundrejt vitit të kaluar. Pozicioni neto i kësaj kategorie, vlerësohet në -11 milionë euro, me një përmirësim të dukshëm krahasuar me vitin paraardhës (-63 milionë euro). Gjatë këtij viti, të ardhurat nga eksporti i shërbimeve u rritën më shpejt se shpenzimet për importe shërbimesh, përkatësisht me 21 dhe 14 për qind kundrejt një viti më parë.

Përmirësimi i pozicionit deficit të shërbimeve, këtë vit i dedikohet bilancit pozitiv të kategorisë "shërbime të tjera" si dhe zgjerimit të suficitit në kategorinë "udhëtime".

Shërbimet e përfituara dhe të ofruara në kategorinë "udhëtime", vazhdojnë të kenë kontributin kryesor në sektorin e shërbimeve për Shqipërinë, me përkatësisht me 70 për qind të të ardhurave dhe 64 për qind të shpenzimeve për këtë nëntëmujor. Turizmi në Shqipëri, aktualisht përfaqëson aktivitetin me prurjet më të larta në valutë për ekonominë shqiptare. Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, eksporti në turizëm, gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2007 ka gjeneruar rreth 754 milionë euro flukse të ardhurash, një vlerë kjo rreth 28 për qind më e lartë se vlera e eksporteve të mallrave.

Rritja vjetore e të ardhurave nga turizmi vlerësohet në rreth 23 për qind. Kjo rritje është influencuar, kryesisht nga rritja e numrit të shtetasve të huaj dhe e emigrantëve që kanë vizituar vendin, ndërkohë që koeficienti i shpenzimeve ditore është luhatur rreth niveleve të një viti më parë dhe ai i ditëqëndrimit vlerësohet në rënie të lehtë.

Ndërkohë, shqiptarët kanë shpenzuar në udhëtimet e tyre jashtë shtetit rreth 700 milionë euro. Vëllimi i shpenzimeve për udhëtime, për vitin 2007, vlerësohet rreth 20 për qind më i lartë krahasuar me një vit më parë, si pasojë e rritjes së numrit të udhëtarëve. Ndërkohë që, koeficienti i kohëqëndrimit dhe shpenzimet mesatare ditore vlerësohen lehtë në rënie.

Bilanci pozitiv i të ardhurave faktoriale në fund të periudhës (169 milionë euro) vlerësohet rreth 21 për qind më i lartë, krahasuar me vitin paraardhës. Rritja këtë vit i dedikohet interesave të akumuluar nga investimi i rezervave valutore të sistemit bankar në institucionet financiare jorezidente, të ardhurave, të përftuara nga investimet tona direkte jashtë dhe investimeve të mjeteve

financiare, në formën e investimeve të portofolit. Të ardhurat neto në formën e interesit nga investimet janë rritur me 45 për qind. Të ardhurat nga puna, përfaqësuan rreth 52 për qind të bilancit pozitiv të të ardhurave. Ndërkohë, Shqipëria gjatë vitit 2007 ka paguar 13.1 milionë euro për të shlyer interesat mbi borxhin e saj të jashtëm, të cilët vlerësohen në rënie kundrejt nivelit të përlogaritur për nëntëmujorin e parë të vitit 2006 (rreth 19 për qind).

Transfertat korente, ashtu si edhe gjatë viteve të kaluara, mbizotërohen nga flukse hyrëse në formën e dërgesave nga emigrantët. Këto të fundit, përfaqësojnë burimin kryesor të financimit të deficitit tregtar (në masën 47 për qind) dhe për nëntëmujorin e vitit 2007, vlerësohen në nivelin 711 milionë euro ose 18 milionë euro më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Prurjet monetare të emigrantëve janë shoqëruar edhe nga transfertat shtetërore, fluksi neto i të cilave për këtë vit vlerësohet rreth 11 milionë euro më i lartë kundrejt vitit 2006.

II. LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE

Flukset neto të kapitalit, gjatë këtij nëntëmujori, regjistruan rreth 598 milionë euro duke mundësuar financim të deficitit korent (në masën 103 për qind) si dhe rritje të rezervave valutore. Pas kësaj shifre pozitive qëndrojnë transfertat kapitale hyrëse prej 65 milionë eurosh si dhe bilanci pozitiv i llogarisë financiare prej rreth 534 milionë eurosh.

Llogaria financiare këtë periudhë përkufizohet në rritje të konsiderueshme të detyrimeve financiare të Shqipërisë me botën (me rreth 633 milionë euro) si dhe rritje të mjeteve tona jashtë (me rreth 99 milionë euro). Krahasuar me nëntëmujorin e parë të vitit të kaluar, fluksi i detyrimeve financiare vlerësohet të jetë rreth 84 për qind më i lartë se një vit më parë, ndërsa rritja e pretendimeve financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës vlerësohet 40 për qind më e ulët.

Rritja e detyrimeve financiare ndaj botës ka ardhur kryesisht prej flukseve hyrëse të kapitalit në formën e investimeve direkte (370 milionë euro) dhe akumulimit të mjeteve valutore në sistemin bankar, ndërkohë, fluksi i huamarrjes me jashtë vlerësohet të jetë rreth 30 për qind më i ulët, kundrejt të njëjtit hark kohor në vitin 2006.

Fluksi i investimeve të huaja direkte arriti vlerën 370 milionë euro kundrejt 201 milionë eurove, realizuar në vitin e kaluar. Këto flukse kapitali janë shndërruar në një faktor dominues në rritjen e detyrimeve financiare dhe në zhvillimet e transaksioneve kapitale e financiare të vendit. Këtë vit ato prezantohen si kapital i huaj, i ardhur kryesisht nga procesi i privatizimit (privatizimi i Albtelekomit).

Fenomeni i rritjes së konsiderueshme të depozitave të jorezidentëve në sistemin bankar, vërejtur në fundin e vitit të kaluar, ka vazhduar edhe këtë nëntëmujor

duke shtuar detyrimet financiare të vendit me rreth 134 milionë euro. Kjo rritje ka ardhur si rrjedhojë edhe e vendosjes së depozitave të emigrantëve në sistemin tonë bankar, shprehje e rritjes së interesit të tyre për të investuar në ekonominë shqiptare.

Ndërkohë, huamarrja duket të ketë ngadalësuar ritmet e rritjes së saj. Lëvrimet e kredive afatgjata dhe të atyre të buta nga jashtë, regjistruan një fluks prej 88 milionë eurosh, që vlerësohet rreth 30 për qind më i ulët krahasuar me fluksin huamarrës në vitin e kaluar. Rritja e detyrimeve të sektorit privat nëpërmjet huamarrjes, ka qenë vetëm me 10 milionë euro nga 27 milionë euro, për të njëjtën periudhë të vitit 2006.

Shërbimi i borxhit të jashtëm ka reduktuar detyrimet tona me rreth 54 milionë euro. Ky nivel përfaqëson vetëm 3.2 për qind të eksporteve tona gjatë këtij nëntëmujori dhe tregon për një aftësi paguese brenda niveleve të pranuar. Nga ana tjetër, pretendimet financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës janë rritur me 99 milionë euro. Rritja e mjeteve është përcaktuar kryesisht nga rritje në mjetet e zotëruara nga sistemi bankar në formën e depozitave jashtë, ndërkohë që investime portofoli të njësive rezidente jashtë kanë ruajtur pothuajse të njëjtin nivel.

Flukset hyrëse të mjeteve valutore në formën e kapitaleve financiare u reflektuan në rritje të Rezervave të Autoritetit Monetar, me rreth 173 milionë euro. Në fund të muajit shtator të vitit 2007 rezerva valutore shënoi nivelin 1.5 miliardë euro, duke qenë e mjaftueshme për të mbuluar rreth 4.2 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

Tabelë 1. Bilanci i Pagesave (në milionë euro).

	9M 2006	9M 2007
Llogaria korente	-391.6	-579.1
Eksporti i mallrave	463.3	588.6
Importi i mallrave	-1663.2	-2085.8
Bilanci tregtar	-1199.8	-1497.3
Shërbimet: kredi	896.7	1085.2
Shërbimet: debi	-959.9	-1096.5
Të ardhurat: kredi	166.9	212.6
Të ardhurat: debi	-26.7	-43.3
Transferta private pa shpërblim	697.2	714.7
Transferta shtetërore pa shpërblim	34.3	45.3
Llogaria kapitale	108.7	64.6
Llogaria financiare	179.2	533.8
Investime direkte	197.7	361.6
Investime portofoli	23.3	-0.7
Kapitale të tjera*	-47.6	167.4
Gabime dhe harresa neto	224.9	153.5
Bilanci i përgjithshëm	121.1	172.7
Mjetet e rezervës	-121.1	-172.7
Përdorim huash e kredish nga FMN	5.8	5.5
Ndryshimi total në rezerva	91.2	146.7
Nga të cilat: ndryshim nga kursi i këmbimit	-29.9	-25.9

* Nuk përfshihen përdorime huash e kredish nga FMN.
Burimi: Banka e Shqipërisë.